

FJALA E DEPUTETES EVIS KUSHI

E ENJTE 30 QERSHOR 2022

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

E kërkova fjalën për të folur për aktin normativ, por do t'u jap përgjigje disa prej kolegëve të opozitës që ngritën akuza për arsimin. Do ta nis me kolegun Dule, i cili deklaroi: "Ministret stolisin kolltukët ministrorë". Për të disatën herë kolegët e opozitës, kur nuk kanë argumente për punën tonë, përdorin shprehje fyese, shprehje diskriminuese, shprehje seksiste. Në të tilla raste është mirë të kërkohet ndjesë, megjithatë, zoti Dule e vendos vetë. Kolegë të tjerë të opozitës kanë kërkuar ndjesë më parë. Nuk e di çfarë do të bëjë zoti Dule, por dua të shpreh reagimin tonë të ashpër ndaj shprehjeve dhe trajtimeve të tilla që u bëhen kolegeve ministre.

Së dyti, u ngritën akuza për maturën shtetërore. Për maturën shtetërore dua t'ju them se këtë vit më shumë se çdo vit tjetër jemi angazhuar maksimalisht, jo vetëm në Ministrinë e Arsimit, por në të gjitha institucionet e varësisë, në të gjitha institucionet arsimore, përfshirë zyrat, shkollat dhe të gjithë mësuesit. Ne kemi filluar të punojmë që në muajin shtator, fillimisht duke hartuar një rregullore të konsultuar mirë me të gjitha grupet e interesit, dhe më pas kemi zhvilluar takime, trajnime me mësuesit, takime me maurantët për t'i orientuar dhe përgatitur me programet orientuese dhe testet paraprake.

Testet janë hartuar nga mësuesit më të mirë, më profesionistë dhe me përvojë të gjatë. Testet kanë qenë pa gabime, kanë qenë brenda programit dhe duke respektuar nivelet e vështirësisë, që do të thotë se testi vlerëson gjithsecilin sipas meritës. Kolegë, testet nuk mund të jenë shumë të thjeshta. Nëse testet janë shumë të thjeshta, penalizohen maurantët e mirë, maurantët e shkëlqyer të notave 9 dhe 10, ndaj testet parashikohen të kenë të gjitha nivelet e vështirësive, nivelin e parë, të dytë dhe të tretë, që diferencon maurantët të cilët meritojnë

vlerësim maksimal. Ju siguroj se testet janë hartuar me përgjegjësinë më të lartë të mësuesve më të mirë, të ekspertëve më të mirë. Ju hodhët akuza pse u korrigjuan gjithë natën.

Ne jemi mësuar të punojmë ditë e natë. Çfarë të keqe ka? Nëse do t'i kishim zvarritur, do të vinit të thoshit: "Keni 1 javë, 2 javë që nuk po korrigjoni testet". Patjetër, do t'i korrigjojmë testet gjithë ditën dhe gjithë natën, që përgjigjet të dalin sa më shpejt për maturantët. Shumë mirë, atëherë. Nëse ju mendoni se korrigjimi i testeve është bërë i drejtë dhe maturantët nuk kanë pasur për çfarë të ankohen, duhet të jeni të lumtur. Ju duhet të ishit të pakënaqur nëse do të ndodhte e kundërta, nëse korrigjimet nuk do të ishin të sakta dhe maturantët do të ishin të pakënaqur. Tjetra, dalja e tezës.

Natyrisht, ne nuk jemi krenarë që pasi fillon provimi i maturës, pas 1 ore, pas 2 orësh apo 30 minutash të dalë testi nga salla. Patjetër që nuk është mirë, por çfarë dua t'ju them për këtë? Në këtë proces ishin të angazhuar 31 000 maturantë dhe 7 000 mësues. Natyrisht, ne i marrim masat që në hyrje të gjithë të kontrollohen me mundësitë, me aparaturat që kemi, por ju e dini sa është përmirësuar sot teknologjia dhe sa e vështirë është të mos shpëtojë ndonjë nga 31 mijë maturantë dhe 7 mijë mësues. Jam e sigurt se ju mezi prisni, në mos të them se interesoheni vetë për të gjetur ndonjë mësues që të bashkëpunojë me ju dhe të nxjerrë testet. E dini çfarë më kujtoni kur ankoheni që dalin testet? Kur bëni mbledhjet e kryesisë së PD-së, jeni 20 veta dhe menjëherë pas 10 minutash, çfarë diskutoni brenda, dalin në gazeta, zbardhen të gjitha.

Imagjinoni, nuk arrini me 20 veta, jo më 31 mijë maturantë dhe 7 mijë mësues. Pavarësisht kësaj, unë e thashë: ne nuk jemi krenarë që del testi, por ju siguroj që dalja e testit nga brenda sallës, jashtë saj, nuk e ka cenuar aspak cilësinë e provimit; ju nuk keni fakte që një test i zgjidhur jashtë të ketë hyrë brenda. Nëse keni, mund të na i thoni dhe ne të marrim masa. Dalja e testit jashtë sallës nuk shkakton diferencim të maturantëve apo ulje të cilësisë së provimit dhe të korrigjimit. Ne patjetër që do të marrim masa për këtë, por ju siguroj se është tepër e vështirë. Sot teknologjia ka arritur aty sa ne as nuk i parashikojmë dot se ku mund të ketë ndonjë mësues, maturant apo aparaturë që fotografon testin.

Gjithashtu, do t'i jap një përgjigje koleges deputete, zonjës Albana Vokshi. Zonja Vokshi dje në gjykatë ka bërë një deklaratë, duke kryer të njëjtën vepër penale për të cilën unë e kam akuzuar dhe e kam thirrur në gjykatë. Dje nuk munda t'i përgjigjesha, pasi isha e ftuar në një event madhështor në Samitin e Parisit, ku ishin të ftuar 145 ministra nga të gjitha vendet e botës, por unë kam ngritur një padi penale për shpifje ndaj zonjës Vokshi në datën 8 prill, e kam thirrur në gjyq. Dje nuk ishte seanca e parë, siç thatë ju, zonja Vokshi, por ishte seanca e tretë. Kam 1 muaj që të pres në gjykatë. Herën e parë nuk erdhe. Herën e dytë isha atje, por sërish nuk erdhe, me pretendimin se nuk kishe marrë njoftim.

Dje, për shkak të angazhimit në Samitin e Parisit, u përfaqësova me avokat, ndërkohë që ju edhe në dy seancat e para nuk ishit e përfaqësuar nga askush. Megjithatë, unë nuk dola as në seancën e parë, kur nuk erdhe, as në të dytën, që ta përdor publikisht, të bëja show mediatik dhe të thosha: Zonja Vokshi nuk erdhi e të tjera, ndërkohë që ju e bëtë këtë. Unë po pres vendimin. Pra, unë kam bërë padi, ju kam akuzuar për shpifje dhe po pres e qetë vendimin e gjykatës, sepse unë i besoj drejtësisë, ndërkohë që ju i hidhni akuzat në facebook. Nëse i besoni drejtësisë, akuzat që shkruani në facebook, çojini në gjykatë dhe më pas bëni show politik me vendimin e gjykatës, por jo pa fakte.

Të ftoj të presim vendimin e gjykatës, të ftoj të gjesh argumente për t'u mbrojtur në gjykatë dhe më pas mund të bëjmë sërish debate politike. Ndërkohë, për aktin normativ, 3 ditë më parë kam qenë në ceremoninë e diplomimit të maturantëve të shkollës Sami Frashëri, një shkollë model, me standardet më të mira bashkëkohore, e cila në shtator do të hapë dyert për nxënësit. Po kështu, javën e kaluar patëm mundësi të shikojmë edhe kampusin e Universitetit Bujqësor të Tiranës. Do ta jap lidhjen tani. Procesi i rindërtimit po sjell institucione arsimore të standardeve më të mira. Këto ishin vetëm dy shembuj nga shumë godina të reja arsimore që po ndërtohen në të gjithë vendin. Vetëm në tri qarqet e dëmtuara nga tërmeti janë 179 objekte arsimore, por duke filluar nga ky vit, ne do të ndërtojmë shkolla të reja edhe në qytete të tjera të vendit.

Të gjitha shkollat janë ndërtuar sipas qasjes: "shkolla, qendër komunitare", me terrene sportive, me biblioteka, me laboratorë, e kështu me radhë. Rindërtimi i shkollave deri tani ka ecur me

ritme mjaft të mira, por të gjithë jemi të vetëdijshëm që prej datës 24 shkurt, kur filloi lufta në Ukrainë, bota po shikon një situatë tjetër ekonomike dhe vala e re e çmimeve natyrisht ka prekur edhe ekonominë tonë, ndaj nisur nga përgjegjësia që ka çdo qeveri për të reflektuar ndaj situatave të jashtëzakonshme dhe në vazhdim të paketës së rezistencës për të përballuar efektet e krizës, vjen akti normativ.

Unë e mbështes këtë akt normativ, sepse është një mundësi shumë e mirë që të zgjidhen problemet e krijuara me rritjen e çmimeve dhe të vazhdojnë punët e mira që kemi nisur, përfshirë dhe ndërtimin dhe rindërtimin e shkollave dhe shumë objekteve të tjera arsimore, ndaj ju ftoj edhe ju, kolegë të opozitës, ta votoni këtë akt normativ. Faleminderit!